



Prishtinë, 18 korrik 2012
Kodi i ZRRE-së: V_433_2012

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 8 paragrafi 1, nënparagrafi 1.6, Nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 2.2, Nenin 25 dhe Nenin 34 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 03/L-185);
- Dispozitat e Nenit 2, paragrafi 3, nënparagrafi 3.1 dhe Nenit 33 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë,

në seancën e mbajtur me datë 18 korrik 2012 nxori këtë:

VENDIM

- I. **MODIFIKOHET Licenca për Operatorin e Tregut të Energjisë (me kushte)** e dhënë Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut të Energjisë (KOSTT Sh.A), –me numër licence ZRRE/Li_16/06, e cila ka qenë e vlefshme nga data 04.10.2006 deri 04.10.2036.
- I. Licenca e modifikuar me numër ZRRE/Li_16/12 do të hyjë në fuqi në datën e nxjerrjes së këtij vendimi dhe do të jetë e vlefshme deri me **04 Tetor 2036**. Obligohet Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut të Energjisë (KOSTT SH.A) që të zbatojë të gjitha dispozitat e licencës së modifikuar.

Arsyetim

- o Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) në dhjetor të vitit 2011 ka filluar procedurën për modifikim të licencës për operatorin e tregut të energjisë për ndërmarrjen e Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT SH.A), të lëshuar nga Bordi i ZRRE-së me datë 04.10.2006. Modifikimi ka filluar në pajtim me Nenin 34 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, si rrjedhojë e ndryshimit të ligjeve në sektor të energjisë.
- o Me 27 janar 2012 ZRRE ka publikuar në ueb faqen e saj draft – licencën e sipërpërmendur për komente nga palët e interesuara. ZRRE ka marrë parasysh edhe komentet e palëve të interesuara dhe përfundimisht ka harmonizuar dispozitat e kësaj licence me legjislacionin primar dhe sekondar në sektor të energjisë.
- o Duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ZRRE ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



- II. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

**Bashkëngjitur licenca e modifikuar.*

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar